



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 15.02.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.02.2019 të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N.SH. "CO- ING "; " NV COMPANY " SH.P.K. nga Prishtina**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndertimi i rrugës "Dëshmoret e Sharbaneve" ne Kolevicë** me Nr. të Prok: **616-18-9300-5-2-1** dhe numër të brendshëm **616 18 151 521** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N.SH. "CO- ING "; "NV COMPANY" SH.P.K. nga Prishtina** të dt. 15.02.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ndertimi i rrugës "Dëshmoret e Sharbaneve" ne Kolevicë**, me Nr. të Prok: **616-18-9300-5-2-1** dhe numër të brendshëm **616 18 151 521**, kundër *Njoftimit për tenderuesin e eliminuar*, të datës 07.02.2019.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin* **Ndertimi i rrugës "Dëshmoret e Sharbaneve" ne Kolevicë**, me Nr. të Prok: **616-18-9300-5-2-1** dhe numër të brendshëm **616 18 151 521**, sipas Njoftimit për dhenje të kontratës me datën: **07.02.2019**.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N.SH. "CO- ING "; "NV COMPANY" SH.P.K. nga Prishtina me datë 15.02.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndertimi i rrugës "Dëshmoret e Sharbaneve" ne Kolevicë**, me Nr. të Prok: **616-18-9300-5-2-1** dhe numër të brendshëm **616 18 151 521**. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.02.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ju njofton se kerkesa juaj per rishqyrtim eshte e paraqitur pas afatit te parapar me LPP dhe me rregullat dhe Udhezuesin e prokurimit publik.

Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit kontraktues eshte ngritur ne pltaformen e E-Prokurimit me daten 07.02.2019, keshtu qe kane kaluar pesë (5) ditet e parapara per paraqitjen e kerkeses per rishqyrtim.

AK – komisioni i vleresimit, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit